



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



REPUBLIC OF KOSOVO
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
Regulatorni Autoritet za Usluge Vode
Water Services Regulatory Authority

Nr. prot./Prot. Br./Prot. No. 434/01
Njësi/Jedinstvo/Unit D
Nr. shënim./Bilje. Dr./Reg. No.
Datë/Datum/Date 06.07.2026

Në mbështetje të nenit 6, paragrafi 2.2 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, si dhe në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nenit 33 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Drejtori i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 03/2026 PËR MBROJTJEN, PËRPUNIMIN, RUAJTJEN DHE SIGURINË E TË DHËNAVE PERSONALE NË AUTORITETIN RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT.

**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi është përcaktimi i rregullave dhe masave për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), në pajtim me legjislacionin në fuqi, me qëllim të sigurimit të ligjshmërisë, konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe përcaktimit të përgjegjësisë të zyrtarëve të ARRU-së lidhur me përpunimin e tyre.

Neni 2

Fushëveprimi

Ky Udhëzim zbatohet për të gjithë zyrtarët, punonjësit, praktikantët, konsulentët, kontraktorët dhe personat tjerë të angazhuar nga ARRU-ja që kanë qasje në të dhëna personale, si dhe për të gjitha format e përpunimit, ruajtjes dhe administrimit të të dhënave personale, qoftë në formë elektronike, fizike apo në çdo formë tjetër, përfshirë edhe punën në distancë dhe përdorimin e sistemeve elektronike jashtë ambienteve të ARRU-së.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim kanë këto kuptime:

1.1. **ARRU** – nënkupton Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit;

1.2. **Kontrollues i të dhënave** – nënkupton Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit, si autoritet publik që përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në pajtim me legjislacionin në fuqi;

1.3. **Përpunues i të dhënave** – nënkupton çdo person fizik ose juridik që përpunon të dhëna personale për dhe në emër të ARRU-së, në pajtim me autorizimet dhe legjislacionin në fuqi;

1.4. **Subjekt i të dhënave** – nënkupton personin fizik të identifikuar ose të identifikueshëm, të cilit i referohen të dhënat personale;

1.5. **Përpunim** – nënkupton çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi;

1.6. **Shkelje e të dhënave personale** – nënkupton çdo shkelje e masave të sigurisë që sjell asgjësimin, humbjen, ndryshimin, deklarimin e paautorizuar, aksidental ose të paligjshëm, ose qasjen në të dhënat personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara ndryshe;

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Udhëzim kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU II

PARIMET E PËRPUNITIT TË TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 4

Parimet e përpunimit të të dhënave personale

1. Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) përpunon të dhënat personale në përputhje me këto parime:
 - 1.1. **Parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës** – të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave;
 - 1.2. **Parimi i kufizimit të qëllimit** – të dhënat personale grumbullohen vetëm për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime dhe nuk mund të përpunohen më tutje në kundërshtim me këto qëllime. Përpunimi i mëtejshëm për qëllime arkivimi në interes publik, hulumtimi shkencor ose historik, apo për qëllime statistikore, nuk konsiderohet në kundërshtim me qëllimin fillestar;
 - 1.3. **Parimi i minimizimit të të dhënave** – të dhënat personale duhet të jenë adekuate, relevante dhe të kufizuara vetëm në atë që është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen;
 - 1.4. **Parimi i saktësisë** – të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara, ndërsa duhet të merren të gjitha masat e arsyeshme që të dhënat e pasakta të korrigjohen ose fshihen pa vonesë;

1.5. **Parimi i kufizimit të ruajtjes** – të dhënat personale ruhen vetëm për atë kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit për të cilin janë mbledhur ose përpunuar. Pas përmbushjes së qëllimit të përpunimit, të dhënat personale asgjësohen, fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose anonimizohen, përveç rasteve kur parashihet ndryshe me legjislacionin në fuqi;

1.6. **Parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit** – të dhënat personale përpunohen në mënyrë që garanton sigurinë dhe mbrojtjen e tyre nga përpunimi i paautorizuar ose i paligjshëm, si dhe nga humbja, asgjësimi ose dëmtimi aksidental, duke përdorur masa të përshtatshme teknike dhe organizative;

1.7. **Parimi i llogaridhënies** – ARRU-ja, si kontrollues i të dhënave, është përgjegjëse dhe duhet të jetë në gjendje të dëshmojë përputhshmërinë me parimet e përcaktuara në këtë nen.

2. Të dhënat personale përpunohen vetëm për qëllime të ligjshme dhe në masën e nevojshme për realizimin e kompetencave dhe përgjegjësi të ARRU-së.
3. ARRU-ja siguron që të dhënat personale të mbrohen nga qasja, përdorimi, zbulimi ose përpunimi i paautorizuar.

Neni 5

Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale

1. Përpunimi i të dhënave personale nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) është i ligjshëm vetëm nëse plotësohet të paktën njëra nga kushtet në vijim:
 - 1.1. subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale për një ose më shumë qëllime të caktuara;
 - 1.2. përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një obligimi ligjor që i nënshtrohet ARRU-së;
 - 1.3. përpunimi është i nevojshëm për ushtrimin e kompetencave dhe autorizimeve zyrtare të ARRU-së;
 - 1.4. përpunimi është i nevojshëm për kryerjen e një detyre në interes publik;
 - 1.5. përpunimi është i nevojshëm për realizimin e të drejtave dhe obligimeve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.
2. Përpunimi i kategorive të veçanta të të dhënave personale lejohet vetëm në rastet dhe kushtet e përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU III

TË DREJTAT E SUBJEKTEVE TË TË DHËNAVE

Neni 6

Të drejtat e subjektit të të dhënave

1. Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë që, në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të informohet dhe të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij/saj lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga ARRU-ja, përfshirë të drejtën:
 - 1.1. të informohet për përpunimin e të dhënave personale të tij/saj;

- 1.2. të kërkojë qasje në të dhënat personale që përpunohen nga ARRU-ja;
 - 1.3. të kërkojë korrigjimin ose plotësimin e të dhënave personale të pasakta ose jo të plota;
 - 1.4. të kërkojë fshirjen e të dhënave personale, në rastet e përcaktuara me ligj;
 - 1.5. të kërkojë kufizimin e përpunimit të të dhënave personale;
 - 1.6. të kundërshtojë përpunimin e të dhënave personale, në pajtim me kushtet e përcaktuara me ligj;
 - 1.7. të paraqesë ankesë pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi.
2. ARRU-ja është e obliguar t'i trajtojë kërkesat e subjekteve të të dhënave në pajtim me afatet dhe procedurat e përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU IV MASAT E SIGURISË

Neni 7 Masat teknike dhe organizative

1. ARRU-ja është e obliguar të zbatojë masa të përshtatshme teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë, konfidencialitetit dhe integritetit të të dhënave personale, me qëllim të mbrojtjes së tyre nga:
 - 1.1. qasja e paautorizuar;
 - 1.2. humbja ose asgjësimi;
 - 1.3. ndryshimi i paautorizuar;
 - 1.4. publikimi ose shpërndarja e paautorizuar.
2. Masat teknike dhe organizative të sigurisë zbatohen në përputhje me natyrën e përpunimit të të dhënave personale dhe përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - 2.1. kontrollin e qasjes në dokumente dhe sisteme;
 - 2.2. përdorimin e fjalëkalimeve dhe autentifikimit;
 - 2.3. ruajtjen e dokumenteve në ambiente të sigurta;
 - 2.4. kopjet rezervë dhe mbrojtjen e sistemeve elektronike;
 - 2.5. evidentimin e qasjeve dhe përpunimeve të të dhënave.

Neni 8 Konfidencialiteti

1. Çdo person i autorizuar që, gjatë ushtrimit të detyrave ose përgjegjësisë të tij/saj, ka qasje në të dhëna personale, është i obliguar të ruajë konfidencialitetin dhe të mos i përdorë apo zbulojë ato në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
2. Obligimi për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale vazhdon edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, kontratës ose çdo forme tjetër të angazhimit në ARRU.

KREU V

RUAJTJA DHE ARKIVIMI I TË DHËNAVE

Neni 9

Ruajtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale ruhen vetëm për atë kohë sa është e nevojshme dhe e arsyeshme për realizimin e qëllimit për të cilin janë mbledhur dhe përpunuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Pas përmbushjes së qëllimit të përpunimit dhe me kalimin e afateve të përcaktuara për ruajtjen e tyre, të dhënat personale:
 - 2.1. fshihen;
 - 2.2. asgjësohen;
 - 2.3. anonimizohen; ose
 - 2.4. arkivohen në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Arkivimi dhe asgjësimi

1. Arkivimi dhe asgjësimi i të dhënave personale bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat, mbrojtjen e të dhënave personale dhe aktet e brendshme të ARRU-së.
2. Dokumentet dhe materialet që përmbajnë të dhëna personale asgjësohen në mënyrë të sigurt dhe të kontrolluar, duke parandaluar rikthimin, zbulimin ose qasjen e paautorizuar në to.

KREU VI

SHKELJET DHE RAPORTIMI

Neni 11

Raportimi i shkeljeve të të dhënave personale

1. Çdo shkelje e sigurisë së të dhënave personale raportohet pa vonesë te personi përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe te menaxhmenti i ARRU-së, në përputhje me procedurat e brendshme dhe legjislacionin në fuqi.
2. Në rast të shkeljes së sigurisë së të dhënave personale, ARRU-ja ndërmerr masat e nevojshme për:
 - 2.1. identifikimin dhe kufizimin e shkeljes;
 - 2.2. minimizimin e pasojave dhe dëmeve të mundshme;
 - 2.3. njoftimin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, kur kërkohet me ligj.

KREU VII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 12 Zbatimi

1. Të gjithë zyrtarët, punonjësit dhe personat e angazhuar në ARRU obligohen të zbatojnë dispozitat e këtij Udhëzimi gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësisë të tyre.
2. Moszbatimi i dispozitave të këtij Udhëzimi konsiderohet shkelje e detyrave të punës dhe trajtohet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të ARRU-së.

Neni 13 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Drejtori i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU).

Prishtinë
Datë 06/07/2026

Drejtori ARRU

Hajrije MORINA

